



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:166447  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05739752

**E.nr.828/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në lëndën përbarimore të kreditorit M.A. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Visar Musa nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 27.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën **E.nr.828/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorës.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.828/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorës, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:166448, të datës 25.01.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 06.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,059.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorës.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.828/23, më datë 27.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**